



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2752 / prot

Tiranë , më 31.10.2022

VENDIM

Nr. 26 , Datë 31.10.2022

“Për

miratimin paraprak të nivelit të pagave të personelit akademik në Universitetin e Tiranës”

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, germa ”h”; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”; VKM-së nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, i ndryshuar; VKM nr. 748, datë 11.6.2009, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, pika 7; Udhëzimit të Përbashkët të MAS dhe MFE nr. 20, datë 20.09.2019, “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; Senati Akademik i UT-së, në mbledhjen e datës 31.10.2022, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Administratori i UT-së,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të pagave të personelit akademik të Universitetit të Tiranës, në kufirin maksimal të tyre sipas Lidhjes nr. 1 “Strukturat dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë“ të VKM nr. 748, datë 11.6.2009, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, pika 7.
2. Burimi i financimit mbi kufirin minimal deri në kufirin maksimal, të përballohet nga të ardhurat që realizon Universiteti i Tiranës, prej shërbimeve të tjera.
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim në përputhje me nenin 49, pika 1 , germa “ç” të ligjit nr. 80/2015.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, por i shtrin efektet financiare prej datës 1 tetor 2022.

KRYETARI

Prof. Dr. Artan HOXHA

